



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1230/5 Prot

Tiranë, më 06.10.2023

VENDIM

Nr. 45, datë 06.10.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Shoqata Rinore Sportive “Studenti”, përfaqësuar nga z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1230 Prot., datë 12.07.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Federata Shqiptare Taekwondo World” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesave për informacion, depozituar pranë Autoritetit Publik në datë 31.05.2023 dhe 09.06.2023 në adresën elektronike general.secretary@albaniantaekwondofederation.com, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/ dokumentacioni, si vijon:

- *Zbardhjen e të gjitha vendimeve të marra nga të gjithë komisionet e Federatës (komisioni ekzekutiv, komisioni teknik, komisioni disiplinës etj) për Shoqatën Rinore Sportive “Studenti” dhe anëtarët e saj, së bashku me dokumentacionet se ku janë mbështetur vendimet.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i nje ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të

informacionit/dokumentacionit sipas kërkesave për informacion datë 31.05.2023 dhe 09.06.2023.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 1230/1 prot., datë 13.07.2023 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesat për informacion si dhe sqarime për zotërimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke vlerësuar në këtë mënyrë kërkesat për informacion, brenda datës 20.07.2023.

Me shkresën nr. 203 Prot., datë 28.07.2023, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 1230/2 Prot., datë 31.07.2023, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *“vendimet e marra nga Këshilli Drejtues i Federatës Shqiptare Taekwondo World i janë nisur Shoqatës Rinore Sportive “Studenti” në email të përbashkët me të gjitha shoqatat anëtare të FSHTW në datë 02.06.2023. Më pas është kërkuar kopje e këtyre vendimeve dhe në datë 18.07.2023 i janë nisur në email kopjet e skanuara të vendimeve të marra nga organet kolegjiale të FSHTW ndaj trajnerit z. . Sjellim në vëmendjen tuaj se FSHTW ka formën juridike të organizatës jofitimprurëse dhe i nënshtrohet ligjit në fuqi për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri dhe procedurave të përcaktuara në të për funksionimin e saj dhe gjithashtu bazon aktivitetin dhe veprimtarinë e saj në Statutin dhe Rregulloren e saj të Brendshme. Ankuesi mund t’i ishte drejtuar fillimisht Federatës sipas procedurave në Rregulloren tonë të Brendshme për ankimim vendimesh (gjë e cila nuk ka ndodhur) dhe pastaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor duke patur parasysh ligjin për OJF-të në Republikën e Shqipërisë, mbi bazën e së cilit Shoqatat marrin statusin juridik si edhe veprojnë e operojnë juridikisht dhe financiarisht.”*

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me pretendimin se, nuk i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar, ka vijuar ankimin, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 1230/3 Prot., datë 23.08.2023, duke specifikuar konkretisht objektin e kërimit si vijon: *“Lënda e vendimeve të dërguara i referohet vetëm vëretjeve të marra ndaj Trajnerit të shoqatës. Ndërkohë ne kërkojmë të zbardhen vendime të cilat kanë pjesë të tyre dhe sportistët e shoqatës, sic është: 1-vendimet e datës 25.05.2023 të komisionit drejtues 2- Vendimet e komisionit teknik mbi sportistët të cilët do të përfaqësojnë ekipin kombëtar në aktivitetet: Kampionati Botëror Senior, Multi European Games, Kampionati European Junior, kriteret ku kanë bazuar përzgjedhjen. 3-Vendimi i komisionit teknik dhe drejtues për pajisjen me breza dhe certifikata të sportistëve që testohen për brezin e kuq. 4-Vendimi i komisionit drejtues për rimbursimin e tarifës së pjesëmarrjes në kampionatin President Cup Albania 2022.*

Me emailin e datës 24.08.2023 Komisioneri ka bërë me dije Autoritetin Publik lidhur me vijimin e ankimit si dhe duke i lënë afat për rivlerësimin e kërkesës brenda datës 29.08.2023.

Në vijim, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje me emailin e datës 29.08.2023 duke sqaruar se: *“1. Vendimet e datës 25.05.2023 i janë nisur Shoqatës në fjalë njësoj si dhe të gjitha shoqatave anëtare të fshtw në emailin e datës 02.06.2023. 2. Po në të njëjtin email ndodhet vendimi i Këshillit Drejtues për pjesëmarrjet në kampionatet Ndërkombëtare kërkuar në pikën 2. (Mbështetur në rregulloren tonë të brendshme, Komisioni Teknik nuk merr vendime të formës ekzekutive dhe vendimet e tij janë propozuese në Këshillin Drejtues dhe vet Këshilli pasi i shqyrton merr vendime dhe Ja dërgon shoqatave anëtare). 3. Vendimet e Komisionit Teknik janë vendim propozime adresuar Këshillit Drejtues dhe nuk janë ekzekutive, ato i vlerëson Këshilli dhe vetëm ai nis vendime ekzekutive shoqatave. 4. Vendimi mbi rimbursimin e Tarifës së President Cup 2022 i është nisur Shoqatës në email njësoj si dhe të gjithë shoqatave të tjera në janar 2022 dhe me pas kemi shkëmbyer emaile konstante për këtë çështje me shoqatën ku është sqaruar për çdo vijimësi të këtij vendimi dhe informuar për procesin. Shoqata Sportive Rinore Studenti është informuar njësoj si cdo shoqatë tjetër anëtare e Federatës në emaile të përbashkëta me të gjitha Shoqatat, konstatojmë nga verifikimet që të gjitha emaillet i ka lexuar nga maili depozituar zyrtarisht në federatë madje në shumicën e tyre ka replikuar apo është përgjigjur. Në lidhje me kërkesën për kopje të njesuara me origjinalin të këtyre vendimeve kjo është praktikë tjetër. Shoqata Sportive Rinore Studenti për ankesat e saj në lidhje me vendimet për cilat është informuar mund të përdor procedurën e akimimit përcaktuar në rregulloren tonë të brendshme nisur disa herë shoqatës me pas KAS sportiv dhe në çdo rast si subjekte të ligjit 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.*

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”,* bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri me shkresën nr. 1230/4 Prot., datë 07.09.2023 ftoi palët në një seancë dëgjimore, me datë 13.09.2023.

Seanca u zhvillua me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesit të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Ndërsa përfaqësuesi i Autoritetit Publik ngriti pretendimin se FSHTW nuk legjitimohet në këtë procedurë administrative me arsyetimin se, kjo e fundit gëzon statusin juridik të organizatës jofitimprurëse. Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioneri i kërkoi përfaqësuesit të Autoritetit Publik të paraqesë në formë shkresore përmbledhjen përfundimtare të qëndrimit të tij.

Në vijim, Autoriteti Publik me emailin e datës 15.09.2023, rikonfirmoi qëndrimin e mbajtur në seancë dëgjimore, si edhe aktet shkresore të sipërcituara, duke pretenduar ndër të tjera se: “...Komisioneri, gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”), pikës 2 të nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit “Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi...”, si dhe gërmës “b” të nenit 65 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”, nuk keni verifikuar statusin juridik të subjektit ndaj të cilit kërkohet fillimi i procedurës administrative, Federata Shqiptare e Taekwondo. Nga dokumentacioni përkatës, rezulton e vërtetuar se Federata Shqiptare e Taekwondo, është shoqatë jofitimprurëse dhe nuk ka asnjë antar të saj, që të jetë autoritet publik. Objekti i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është garantimi i njohjes së publikut me informacion, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike.

Në kuptim të nenit 2, pika 1 e ligjit të sipërcituar “Autoritet publik”: a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike...pra rezulton qartë dhe në mënyrë eksplicite dhe taksative ligjore se, që Federata Shqiptare e Taekwondo të jetë objekt i këtij shqyrtimi, duhet t’i jetë dhënë e drejta e funksioneve publike, gjë e cila nuk ekziston të jetë kryer nga asnjë autoritet publik për këtë Federatë.

Pra, bie poshtë pretendimi se meqenëse kjo Federatë mund të marrë fonde publike, atëherë quhet autoritet publik, pasi edhe neni 8 pika 2, I LIGJIT Nr. 79/2017 PËR SPORTIN ndryshuar me LIGJIN Nr. 105/2020, e shpreh qartë.... Ministria përgjegjëse për sportin bashkëpunon me to për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar pavarësinë e funksionimit të tyre, administron objektet sportive publike, që ka në juridiksion, dhe financon ndërtimin e mirëmbajtjen e mjediseve sportive.

Ska as llogjik ligjore, as bazë ligjore, por mbi të gjitha kjo llogjikë që kërkohet të përdoret, se mqs ke akses në fonde publike, quhesh autoritet publik, bie ndesh pikërisht me parashikimet ligjore të mësipërme. Federata Shqiptare e Taekwondo është subjekt i Ligjit nr. 8788/2001 “PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE” i ndryshuar me: Ligjin nr. 9814, datë 4.10.2007 dhe Ligjin nr. 92/2013, përkatësisht nenet 3 dhe 28, datë 28.02.2013, Ligji Nr. 80/2021 “PËR REGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE”; LIGJIT Nr. 79/2017 “PËR SPORTIN” i ndryshuar me LIGJIN Nr. 105/2020, si dhe Kodi Civil të Republikës së Shqipërisë, si edhe zhvillon aktivitetin e saj

dhe rregullon marrëdhëniet e saj me antarët e saj dhe palët e treta, konform dhe sipas parashikimeve të Statutit dhe Rregullures së brendshme të saj.

Për sa më sipër parashtruar, rezulton se Federata Shqiptare e Taekëondo nuk është autoritet publik, në kuptim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Për rrjedhojë, për shkak të mungesës së legjitimitit të palës në këtë procedurë administrative, si subjekt i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, ankesa e paraqitur nuk mund ti nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, por dispozitave ligjore për Organizatat Jofitimprurëse, Ligjit për Sportin dhe Statutit e Rregulloreve të Brendshme të kësaj Federate.”

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitatat dhe parimet e LDI.

Lidhur me pretendimin e Autoritetit Publik se, *edhe pse Federata mund të ketë akses në fonde publike, kjo bie ndesh me parashikimin ligjor të cituar në pikën 2 të nenit 8 të Ligji nr. 79/2017 “Për Sportin” i ndryshuar, Komisioneri vlerëson se ai nuk qëndron.*

Bazuar në ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin” i ndryshuar, konkretisht në pikën 1 të nenit 8 parashikohet se: *“Ministria përgjegjëse për sportin harton dhe zbaton politikën shtetërore në fushën e sportit, plotëson dhe përmirëson kuadrin ligjor të sportit, administron fondet buxhetore për sportin dhe kontrollon përdorimin e tyre nga organizatat sportive. Neni 13 i ligjit të sipërcituar përcakton se: “Federatat sportive, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizata Kombëtare Antidoping financohen me fonde të dhëna nga buxheti i shtetit në formë transferte, të parashikuara në buxhetin e shtetit, si dhe nga burime të tjera të ligjshme. 2. Financimi I federatave sportive olimpike, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatës Kombëtare Antidoping përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për sportin. 3. Ministria përgjegjëse për sportin financon federatat joolimpike me projekte nga buxheti i saj në formë transferte për veprimtari të propozuara prej tyre, duke pasur në konsideratë impaktin social, ekonomik dhe mjedisor. 4. Ministria përgjegjëse për sportin mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë dhe administrimin e transfertës së buxhetit të shtetit në të gjitha organizatat sportive që kanë përfituar nga fondet publike. Neni 39 i këtij ligji përcakton se, 1. Fondet e Buxhetit të Shtetit për sportin përcaktohen në Buxhetin vjetor të Shtetit. 2. Në financimin e sportit përfshihen edhe burimet financiare nga pushteti vendor, organizatat sportive, federatat ndërkombëtare sportive, bastet sportive, donacionet, sponsorizimet, e drejta televizive, reklama dhe nga ndonjë burim tjetër i ligjshëm.*

Në analizë të dispozitave të sipërcituara, interesi publik për të aksesuar informacion/dokumentacion lidhur me mënyrën e përdorimit të fondeve të dhëna, kontrollit të përdorimit të tyre, ushtrimin të detyrave, funksionimit dhe veprimtarisë me karakter publik të Autoritetit Publik në sportin e taekwondo, është i lartë.

Sa i përket pretendimit të Autoritetit Publik se, *FSHTW zhvillon aktivitetin e saj dhe rregullon marrëdhëniet e saj me antarët e saj dhe palët e treta, konform dhe sipas parashikimeve të Statutit dhe Rregullures së brendshme të saj*, Komisioneri vlerëson se këto referenca përforcojnë edhe më tepër qëndrimin se FSHTW është Autoritet Publik. Statuti i Autoritetit Publik në nenin 19 të tij parashikon: *“Të ardhurat e FSHTW sigurohen nga Fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit, në formë transferte, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit, si dhe burime të tjera të ligjshme. Mënyra e përdorimit të këtij fondi përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe të Ministrisë Përgjegjëse për Sportin. Ministria Përgjegjëse për Sportin mbikëqyr dhe kontrollon administrimin e transfertës së Buxhetit të Shtetit në të gjitha organizatat sportive që kanë përfituar nga fondet publike etj”*. Ndërsa, në Rregulloren e Brendshme, pika 2, shkronja a), b) dhe f) në nenin 23 përcakton: *“Procedura e përdorimit të Fondit Grand të miratuar nga Ministria përkatëse është si me poshtë: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Drejtues dhe Sekretari i Përgjithshëm në fund të vitit parashikojnë aktivitetet dhe koston e tyre për vitin pasardhës duke bërë kërkesë në Ministri. Pasi Ministria miraton Fondin Grand për detajimin e këtij fondi vendos Asambleja e Përgjithshme ose Këshilli Drejtues në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm dhe Punonjësi i Financës sipas kalendarit të aktiviteteve dhe prioriteteve të FSHT-W. Të gjitha procedurat e shpenzimit financiar të kryera nga Fondi Grand janë objekt auditimi i Ministrisë përgjegjëse.*

Ndërkohë, neni 18, 34, 35 dhe 36 i saj parashikon se: *FSHTW është i vetmi institucion në Shqipëri që ka të drejtë të japë Liçensën e ushtrimit të profesionit të Trajnerit, Gjyqtarit dhe Specialistit Teknik në sportin Taekwondo; të organizojë Kampionatin Kombëtar i Dyluftimit në Taekwondo; të organizojë Kampionatin Kombëtar të Demonstrimit në Taekwondo; është i vetmi institucion në Republikën e Shqipërisë që ka të drejtë të organizojë Kupën e Shqipërisë”*.

Për sa më sipër, nisur edhe nga qëllimi dhe objektivat e Autoritetit Publik, vërehet se këtij të fundit i është dhënë e drejta e funksioneve publike nga autoritetet përkatëse, dhe si rrjedhojë, dhënia e informacionit objekt shqyrtimi nuk cenon kurrësesi pavarësinë e institucionit, por forcon transparencën dhe përgjegjshmërinë e këtij të fundit.

Theksojmë se, qëndrimi i Komisionerit sa i përket legjitimitetit të Autoritetit Publik bazohet edhe në një rast tjetër të trajtuar më herët me ankesën nr. 1935 Prot., datë 22.12.2014 nga Qendra “Res Publica” me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”* ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit. Konkretisht, me shkresën nr. 1935/1 Prot., datë 12.01.2015 Komisioneri në ushtrim të kompetencave ligjore, për të qenë sa më objektiv në vendimmarrjen e tij (në referencë të nenit 24 të LDI) ka kërkuar opinion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nëse statusi ligjor i Federatës Shqiptare të Futbollit është në përputhje me parashikimin e dhënë në shkronjën b), c) të pikës 1 të nenit 2 të LDI.

Në përgjigje të shkresës së dërguar nga Komisioneri mbi opinionin, nëse Federata Shqiptare e Futbollit është pjesë e përcaktimeve të ligjit 119/2014, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka informuar si më poshtë vijon: *“Bazuar në Ligjin nr. 9376, datë 21.04.2015 "Për Sportin Federatat Shqiptare të Sportit janë persona juridik, organizata sportive, të cilat veprojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 8789 datë 27.05 2001 "Për*

regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" të cilat kryejnë një mision publik të deleguar nga shteti për zhvillimin dhe organizimin e veprimtarive sportive. Për sa më sipër, Federatat Shqiptare të Sportit, sikurse dhe Federata Shqiptare e Futbollit janë ente publike dhe kanë detyrimin ligjor në përputhje me parashikimin e dhënë në nenin 2 pika l shkronja b/c/ të ligjit nr.119/2014 Për të Drejtën e Informimit "

Në vijim, Komisioneri përmes vendimmarrjes së publikuar në faqen zyrtare, konkretisht në linkun https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/vendim_16_fshf.pdf, ka vendosur urdhërimin e Autoritetit Publik/Federata Shqiptare e Futbollit për vënien në dispozicion të dokumentit të kërkuar ankuesit.

Për sa më sipër, në kuptim të pikës 1, të nenit 2 të LDI "Autoritet publik": a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës "c" të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Në analizë të parashikimeve të mësipërme, FSHTW edhe pse gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse, pavarësi drejtuese, administrative dhe teknike, është person juridik, i cili ushtron funksione publike dhe nuk përjashtohet si subjekt i ligjit nr.119/2014. Për rrjedhojë, detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies. Për më tepër që ankuesi është anëtar i Autoritetit Publik dhe dhënia e dokumentacionit të kërkuar, parashikohet edhe në Statutin e Autoritetit Publik në pikën 11 të nenit 4 dhe në shkronjën c) të pikës 1, të nenit 5, të cilat përcaktojnë në thelb bërjen publike të informacionit objekt shqyrtimi, duke shprehur konkretisht se: "Anëtarët e FSHT-W kanë të drejtë të marrin dijeni për të gjithë vendimet dhe veprimtaritë sportive të FSHT-W".

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: "1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike."

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik". Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse

ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përfundimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1230 Prot., datë 12.07.2023, të Shoqatës Rinore Sportive “Studenti”, përfaqësuar nga z. _____, kundër Autoritetit Publik “Federata Shqiptare Taekwondo World”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesave për informacion datë 31.05.2023 dhe 09.06.2023, konkretisht: (“Zbardhjen e të gjitha vendimeve të marra nga të gjithë komisionet e Federatës (komisioni ekzekutiv, komisioni teknik, komisioni disiplinës etj) për Shoqatën Rinore Sportive “Studenti” dhe anëtarët e saj, së bashku me dokumentacionet se ku janë mbështetur vendimet”), brenda datës 13.10.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 06.10.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi